



Raporti për muajin prill 2017 i ndjekjes së Kapitullit 23 – gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore

I GJYQËSORI

Pavarësia

Është hedhur poshtë kundërshtimi i gjykatëses së lartë Lidija Nedellkova

Ish-kryetarja e Gjykatës së Lartë, Lidija Nedellkova nuk do të marrë pjesë në këshillin penal në Gjykatë i cili vendos se a është i ligjshëm vendimi për paraburgim të biznesmenit Sead Koçan pasi kundërshtimi i saj për transferim në njësi tjetër është hedhur poshtë në Seancën e përgjithshme të Gjykatës së Lartë. Nedellkova është ankuar për këtë vendim të kryetari i Gjykatës së Lartë, Jovo Vangelovski që të transferohet në njësinë për gjykim në afat të arsyeshëm. Në vend të saj është vendosur gjykatësja Snezhana Bajlozova, ekspertiza primare e të cilës janë procedurat qytetare. Tanimë nuk ekzistojnë pengesa, Gjykata e Lartë të vendosë seancën publike në të cilën do të vendosë se a janë ligjore vendimet e marra nga gjykatat më të ulëta dhe a do të kthehet lënda e paraburgimit të z. Koçan për rimarrje të vendimet të gjykata e procedurës paraprake.

Janë hedhur poshtë 17 kundërshtimet e gjykatësve të Gjykatës Themelore Shkup 1 për transferim

Gjykata e Lartë i hodhi poshtë të 17 kundërshtimet e gjykatësve të Gjykatës Themelore Shkup 1 të cilët nuk ishin të kënaqur nga renditja e u.d. kryetarit Stojançe Ribarev. Renditja e z. Ribarev në publik shkaktoi kontroversë për shkak të degradimit të gjykatësve me përvojë dhjetra vjeçare mbi materialin penal me transferimin e tyre në pozita më të ulëta, si dhe të gjykatësve të cilët kanë vendosur pozitivisht për kërkesat për shqyrtim dhe kundërshtim të PSP-së. Këto transferime shkojnë në llogari të përparimeve të gjykatësve të cilët janë përfshirë në bisedat e përgjuara, por dhe që njihen në publik si pengues të punës së PSP-së. Ribarev e ka miratuar rendin kontestues pasi rendi i paraardhëse së tij Tatjana Mihajlova është anuluar para pak kohësh nga Gjykata e Lartë e cila miratoi shtatë prej tetë kundërshtimeve të gjykatësve të rishpërndarë.¹

¹http://www.sud.mk/wps/portal/vsrm/sud/vesti/9e27d8d8-bf1b-4851-b431-88de1f016814!/ut/p/z1/rVlJbslwEP2aHC2PQ5bhaBBLaSlqgSbxBWUft8QJYKDI62tOIVqVUNG5jfsWWeaNHBO2pUPFB LmMtKxWvzR4Jb-ENHAFwHh5w-twB3gMfZ2000PNpcAkW6AMVI kvVFCRKl3rFY3qfbKW6aJ8s2C3zyyoqzTXKrbgkO-0tKcD236GGZKkYAlx0GUkcVqMIGY5K4B5yJyzXp3KjEZXoYOmgOf74ZfhYPiiCRIZC_LYjLs-8DnPeZyfLin3PzwlPMjnatqW5qXT - YYPjD4VulkXujw0X56Z13o_yoqSOMhPJ1sxHcNKVSON_XNPYXqhhhezvujpfm3liviFRFRcOrqHU5L7H1QdSp80gG3QSPs6IMcPcJJsCYWA!!/dz/d5/L2dBISEvZ0FBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F9e27d8d8-bf1b-4851-b431-88de1f016814





Këshilli Gjyqësor transferoi 7 gjykatës nga gjykatat e apelit prej brendësisë së shtetit në Gjykatën e Apelit Shkup për periudhë prej 3 muajsh

Këshilli gjyqësor në seancën e 251 mori vendim transferim të përkohshëm për ushtrim të funksionit gjykatës të shtatë gjykatësve prej gjykatave të apelit në brendësi të shtetit në Gjykatën e Apelit Shkup. Tre prej gjykatësve të Gjykatës së Apelit në Manastir, tre gjykatës së Gjykatës së Apelit Gostivar dhe një gjykatës nga Gjykata e Apelit Shtip do të kryejnë funksionet e veta në Gjykatën e Apelit Shkup. Bëhet fjalë për transferim të përkohshëm prej vetëm 3 muajsh.²

Paanësia

Gjykata e Lartë – Është refuzuar kërkesa e PSP-së për përjashtim të kryetarit të gjykatës Vangelovski

Gjykata e Lartë në seancë të përgjithshme mori vendim me të cili refuzohet kërkesa e PSP-së për përjashtim të kryetarit të Gjykatës, Jovo Vangelovski nga marrja e vendimeve për kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së prokurorisë së Zverlevskit. PSP-ja dorëzoi kërkesë për përjashtim të Vangelovskit sepse kryetari i Gjykatës është përfshirë në bisedat e përgjuara dhe kjo në bisedat e ish-ministrit të transportit dhe lidhjeve, Mile Janakievski, kështu që, sipas PSP-së, vihet në pikëpyetje paanësia e tij. Vangelovski e ka komentuar kërkesën si joserioze. Me këtë vendim Vangelovski mbetet në këshillin penal i cili do të vendosë për ligjshmërinë e parburgimit për Sead Kočan.

Gjykata e Lartë e shqyrton kompetencën e Prokurorisë Publike të RM-së për dorëzim të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë në lëndët e PSP-së

Gjykata e Lartë e vazhdoi Seancën e përgjithshme ku janë refuzuar kërkesa e PSP-së për përjashtim të Vangelovskit, kundërshtimet e Nedellkovës dhe të gjykatësve të Gjykatës Themelore Shkup 1. Gjykata informoi se në seancën e vazhduar do të shqyrtohen referatet për çështjet juridike “Kompetenca për dorëzim të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë” dhe “Se a mund të përdoren dëshmitë e marra në mënyrë joligjore si dëshmi në procedurë gjyqësore”.³ Prokuroria Publike e RM-së nga fundi i muajit mars

²http://sud.mk/wps/portal/ssrm/sud/vesti/a76076d6-d253-4d9a-9416-9cd30517266a!/ut/p/z1/tZNdT8lwFlZ_ixe7bNpuXbtdTmUQ5EOCE9YbUtcOKu4DqPPj11sSEwNE0KBNk6bJe57z9pxTYOEU8II0ei6MrkrxZO8ppzPaJgQFN6gXdK9DFCXEi0e3d5gwAie7gjYeBIYwTGjYid0k8SA_Hn8POeRZaWqzgOmmapSZFUsHbZ6lg-

³http://www.sud.mk/wps/portal/vsrm/sud/vesti/02694bcd-d266-4658-9c93-0ee376c3328c!/ut/p/z1/rVJNT8JAEP01PW5mbMt2e1xIAVEkWiP0L6RsC6zSbYGlqL_e5WSiETA4t0nex7zJAwFTEDpr1DlzqTLZ2u6poDPa831kd3jP4qc28ggDNg45YhTA5BSg10UQp_nPIEBIbWqzgrTez9dKzspXB3f73MG6koXRmYNNsTPKQXRp6M9ITnKXUuLTFiOhDD2CReEFVHqey-RRr5Yqh_Qi9ORcwOP9-MtwTtHxxDpJai-DLYtTvBsiT6KbF2aM74vaHjSoOkOhqW9qXx39M0P_h8C3EoHWlw0n5-JzEKt841x1FbQvWy2Qhum1JpU7wZmP5LVaywux12hkt7b2ZWROIFBdOLqHWZIMx7J_qj_UB6nTk7jBflh00-





ka dorëzuar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë së vendimit të gjykatës në procedurën paraprake për përcaktim të masës paraburgim për biznesmenin Sead Kočan. Kështu hapet dilema juridike se a ka kompetenca kjo prokurori që të dorëzojë mjete juridike të jashtëzakonshme për lëndët e PSP-së. Pas shqyrtimit të referatit të Vangellovskit, kanë votuar gjithsej 19 gjykatës, prej të cilëve 10 për kompetencë për dorëzim të mjeteve juridike të jashtëzakonshme për lëndët e PSP-së. Megjithatë, kjo nuk e përbën kuorumin e nevojshëm prej 50% + 1 gjykatës nga numri i përgjithshëm prej 21 gjykatës.

PTHP Shkup ka ngritur procedurë kundër 15 pjesëmarrësve në trazirat e dhunshme në Kuvend

Prokuroria Themelore Publike Shkup e informoi publikun se deri në momentin e dërgimit të lajmërimit ka identifikuar 15 persona të involvuar në trazirat të cilat ndodhën në Kuvendin e RM-së. Nga PTHP-ja thonë se vepron sipas fletëparaqitjes penale të dorëzuar nga MPB-ja. Janë marrë në pyetje një numër i madh personash midis të cilëve edhe përfaqësues të policisë.⁴ PTHP-ja informon se pas mbledhjes së materialit dëshmitar relevant, për pesëmbëdhjetë personat e involvuar në trazirat në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, së pari ka filluar procedurë për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se kanë kryer vepër penale – Pjesëmarrje në turmë që do të ndalojë personin zyrtar në kryerjen e veprimeve zyrtare nga neni 384 të Kodit Penal. Prokuroria shton se shtatë persona janë privuar nga liria. Prokurori publik kompetent, duke vlerësuar se janë përmbushur bazat ligjore, për katërmbëdhjetë prej të dyshuarve ka propozuar që gjykatësi në procedurë paraprake t'u përcaktojë masë paraburgim. Për një person është propozuar përcaktim i masave të kujdesit. PTHP-ja siguron se hetimi i prokurorisë vazhdon në drejtim të zbardhjes së tërësishme të ngjarjes penale-juridike.⁵

II LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

PSP-ja po kryen hetime financiare për një numër të madh personash fizikë dhe juridikë

PSP-ja informoi se tashmë po kryen procedura parahetimore të cilat kanë si qëllim zbatimin e hetimeve financiare kundër një numri më të madh personash fizikë dhe juridikë. Qëllimi i këtyre procedurave parahetimore sipas PSP-së është kontrolli i gjendjes pronësore të të gjithë personave për të cilët janë hapur procedura dhe për punën e tyre të përgjithshme financiare. Kontrolli i gjendjes pronësore nënkupton kontrolle të detajuara të pronës së përgjithshme që mund ta posedojnë personat, si pasurinë e patundshme ashtu edhe atë të tundshme. PSP-ja u drejtohet institucioneve shtetërore që të marrin masë me të cilat do të pamundësohet shpallja e të dhënave për procedurat parahetimore të cilat, në përputhje me dispozitat ligjore, janë sekrete. Prokuroria tërheq vëmendjen se nuk është e lejueshme që organet shtetërore t'u lejojnë mbikëqyrje personave për të cilët kryhen kontrollet në llojin dhe

[ARGHlaE! /dz/d5/L2dBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F02694bcd-d266-4658-9c93-0ee376c3328c](http://www.rrjeta.org.mk/dz/d5/L2dBIS9nQSEh/?urile=wcm%3Apath%3A%2Fpublic_mk%2Fsud%2Fpocetna%2Fvesti%2F02694bcd-d266-4658-9c93-0ee376c3328c)

⁴ <http://jorm.gov.mk/?p=4002>

⁵ <http://jorm.gov.mk/?p=4006>





karakterin e kontrollimeve të cilat i kryen kjo prokurori publike, në përputhje me dispozitat dhe autorizimet ligjore.⁶

Takim midis prokurorëve të PSP-së dhe udhëheqësve të “Telekomit të Maqedonisë”

PSP-ja informoi se në hapësirat e “Telekomit të Maqedonisë” është mbajtur takim punë në nivel më të lartë me përfaqësuesit e kësaj kompanie, me qëllim që të gjendet zgjidhje për lëndët në interes të kësaj prokurorie publike. Nga prokuroria thonë se presin që bashkëpunimi i vendosur të vazhdojë edhe në periudhën në vazhdim.⁷ Në periudhën e kaluar disa media shpallën informacione se “Telekomi i Maqedonisë” nuk ka bashkëpunuar me PSP-në dhe se operatorët e tjerë të telefonisë celulare VIP dhe ONE (tani të bashkuar në një operator) kanë bashkëpunuar, por nga Telekomit kanë refuzuar të jenë pjesë e hetimit të PSP-së. “Telekomi i Maqedonisë” e kontrollon pjesën më të madhe të tregut të telefonisë celulare në Republikën e Maqedonisë.

PROCEDURA MË TË RËNDËSISHME GJYQËSORE

“MITO”

Më 03.04.2017 duhej të mbahej seanca kryesore e rastit “Mito” ku është akuzuar lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, për veprën penale “Marrje mito”. Seanca është shtyrë sepse mbrojtësit e të akuzuarit e kanë informuar gjykatën se prokuroria nuk ua ka dorëzuar dëshmitë në bazë të të cilave duhet ta përgatisin mbrojtjen, edhe pse në përputhje me Ligjin për Procedurë Penale, duhej t’u ish dhënë që kur është dorëzuar akti i prokurorisë. Në këtë drejtim, gjykatësi e ka obliguar prokurorinë t’ia dorëzojë dokumentet mbrojtjes, me qëllim që të përgatisë mbrojtjen. Seanca e ardhshme është caktuar të mbahet më 04.05.2017.

ZORAN BOZHINOVSKI

Seanca e caktuar më 26.04.2017 për gjykim sipas lëndës KOK-79/16, ku si i akuzuar për veprat penale “Shoqërim kriminel” dhe “Spiunim” është gazetari Zoran Bozhinovski, është shtyrë. Shkaku për shtyrjen e tij është mosarritje e organeve të ndjekjes të dëshmitari/i dëmtuari në këtë lëndë. Gjykata ka pasur njohuri se dëshmitari gjendet në Beograd, por duhej t’i drejtohej me shkrim Gjykatës së Lartë në Beograd. Mbrojtja kërkon të njëjtin qëndrim si në seancat e mëparshme dhe kërkoi që të mundësohet lidhje konferenciale që ai të merret në pyetje. Propozimi i tillë i mbrojtjes është miratuar nga gjykata. Seanca e ardhshme për këtë gjykim është caktuar për më 26.05.2017 në orën 11.00.

⁶ <http://www.jonsk.mk/2017/04/04/%D0%B2%D0%BE-%D1%82%D0%B5%D0%BA-%D1%81%D0%B5-%D0%BF%D1%80%D0%BE%D0%B2%D0%B5%D1%80%D0%BA%D0%B8-%D0%BF%D0%BE%D0%B2%D1%80%D0%B7%D0%B0%D0%BD%D0%B8-%D1%81%D0%BE-%D1%84%D0%B8%D0%BD%D0%B0%D0%BD%D1%81%D0%B8/>

⁷ <http://www.jonsk.mk/2017/04/24/%D0%BE%D0%B4%D1%80%D0%B6%D0%B0%D0%BD%D0%B0-%D1%80%D0%B0%D0%B1%D0%BE%D1%82%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%80%D0%B5%D0%B4%D0%B1%D0%B0/>





“LAGJJA E TRIMAVE”

Seancat për lëndën KOK.nr.127/15, e njohur në publik si “Lagjja e trimave”, gjatë këtij muaji ishin të hapura për publikun dhe në të merrreshin në pyetje dhe dëgjoheshin të akuzuarit. Para gjykatës mbeti të merret në pyetje edhe një prej 37 të akuzuarve gjithsej. Në seancën që u mbajt më 25.04.2017 gjashtë prej të akuzuarve e tërhoqën propozimin e tyre për marrje në pyetje para gjykatës. Seanca e caktuar më 27.04.2017 me kërkesë të mbrojtësve në këtë procedurë nuk u mbajt me shpjegimin se u duhej më tepër kohë që të dorëzojnë në gjykatë plotësim të dëshmime me arsytim për to. Seanca e ardhshme është caktuar të mbahet 05.05.2017. Procedura gjyqësore në këtë lëndë vijon në përputhje me dispozitat e Ligjit për Procedurë Penale dhe pa shkelje të tyre. Në këtë lëndë të akuzuarit gjykohen për veprat penale “Terrorizëm” dhe “Organizatë terroriste”. Seancat e ardhshme për këtë lëndë janë caktuar për më 5,9,11,15,17,19,23,29 dhe 31 maj 2017.

“ERAZMUS”

Është shtyrë edhe gjykimi më 18.04.2017 për rastin “Erazmus” ku si të akuzuar janë gjashtë profesorë dhe demonstratorë të Fakultetit Ekonomik në Shkup, për veprat penale “Marrje mito”, “Marrje shpërblim për ndikim të paligjshëm”, “Keqpërdorim të pozitës dhe autorizimeve zyrtare” dhe “Dhënie mito”. Shkaku për këtë shtyrje ishte mungesa e një prej të akuzuarve. Seanca e ardhshme është caktuar më 26.05.2017 në orën 10.

PAVLE BOGOEVSKI K-1526/16

Seanca për përfaqësuesin e Revolucionit Laraman, Pavle Bogoevski, dhe deputet në përbërjen e re të Kuvendit e caktuar për më 26.04.2017 është shtyre. Nuk ka pasur kurrfarë veprimesh në procedurë sepse prokurori publik e ka informuar gjykatën se nuk mund të vijë në seancën e sotme për shkak të obligimeve të tjera, kurse, gjithashtu edhe i akuzuari nuk ishte i pranishëm në seancën e vendosur për sot. Për këto arsye seanca nuk u mbajt, kurse gjykata informoi vetëm për datën e ardhshme se kur është vendosur seanca e ardhshme – më 29.05.2017 në orën 10,00.

“KOK-95/16”

Lënda e regjistruar me numrin KOK-95/16 lidhet me procedurën e ndarë për një të akuzuar për pjesëmarrje në ngjarjet e Kumanovës të 9 majit 2015 i njohur në publik si “Lagjja e Trimave”. I akuzuari ngarkohet me veprat penale “Terrorizëm” dhe “Organizatë terroriste”. Seanca më 28.04.2017 ishte, gjithashtu, e hapur për publikun ku procedura është në fazën e pasqyrimin të dëshmime materiale dhe me shkrim nga prokuroria publike. Për shkak të thirrjes së dëshmitarëve në këtë procedurë, seanca është shtyrë për më 10.05. 2017 në orën 10,00. Seancat e ardhshme janë caktuar për më 22, 26 dhe 30.05 të gjitha në orën 10.00.





DOV nr. 08-12/4 – lëndë para Këshillit Gjyqësor të RM-së

Bëhet fjalë për lëndë për shkarkim të gjykatësit, ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit në Shkup, Jordan Mitrinovski, i cili ka ngritur procedurë para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ku është përcaktuar se ka ekzistuar lëndim i nenit 6 të GJEDNJ-së. Në bazë të atij aktgjykimi Këshilli Gjyqësor ka vendosur ta përsëritin procedurën për shkarkim edhe pse tani gjykatësi i mëparshëm është në pension. Para fillimit të seancës Këshilli Gjyqësor i përbërë nga 5 anëtarë informoi se mbrojtësi i ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit, Jordan Mitrinovski ka dorëzuar kërkesë për shtyrje të debatit me arsyetim shkaqe private sepse nuk ka pasur mundësi të marrë pjesë sot. I pranishëm ishte dhe dorëzuesi i kësaj kërkesë kryetari i Gjykatës së Lartë, Jovo Vangelovski. I akuzuari tha para gjykatës se do që mbrojtësi i tij në procedurë paraprake të jetë i pranishëm, por se edhe ai vetë mund të mbrohet nëse është e nevojshme kjo. Ai nuk e dinte për se është caktuar kjo seanca sot dhe për se do të vendosë Këshilli Gjyqësor. Përmendi se ka pyetje të cilat do t'i parashtrijë nëpërmjet Arkivit të gjykatës që gjykatësit të njihen me to. Për shkak të mungesës së kushteve seanca u shty për më 11.05.2017 në orën 10,00.

III. TË DREJTA THEMELORE

Sundimi i të drejtës – Dhuna në Kuvendin e RM-së

Më 27 prill, tubimi publik i iniciativës “Për Maqedoni të përbashkët” përfundoi me përdorim haptas të fuqisë, shkaktim të rrezikut të përgjithshëm dhe rrezikimin e sigurisë, përkatësisht të integritetit psikik dhe fizik të përfaqësuesve të popullit nga disa parti parlamentare, një pjesë e nëpunësve policorë të cilët u përpoqën ta mbrojnë ndërtesën e Kuvendit dhe para së gjithash jetët e përfaqësuesve të popullit. Ndryshimi i tillë dhunues në tubimin e iniciativës “Për Maqedoni të përbashkët” dëshmoi kulminimin e nacionalizmit dhe të retorikës tjetër përjashtuese, të gjuhës diskriminuese dhe të gjuhës së urrejtjes, të cilat ishin të pranishme në fillim të tubimeve të kësaj initiative, por si të tilla ishin të pranueshme edhe në deklaratat publike të udhëheqësit dhe të anëtarëve të VMRO-DPMNE-së.

Hyrja me dhunë, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, e turmës ku kishte edhe persona të maskuar, nëpunës publikë si kryetarë komunash dhe drejtorë të ndërmarrjeve publike, kishte qëllim të qartë me të cilin u shkelën një sërë dispozitash ligjore të më tepër ligjeve (Ligji për Policinë, Ligji për Tubime Publike, Kodi Penal) dhe Kushtetuta. Efektet e hyrjes së tillë të dhunshme në shtëpinë ligjvënëse, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, midis të tjerash i interpretoi: “Sipas Kodit Penal, ushtrimi i dhunës së ashpër nga një grup mbi më tepër qytetarë që në publik shkakton ndjenjë të pasigurisë, rrezikim dhe frikë është vepër e rëndë penale. Shihet qartë se mosveprimi i nëpunësve policorë është prodhim i urdhrat joligjor dhe i keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Për veprimet e tilla përgjegjësi mbajnë dhe udhëheqësit dhe kryerësit.”⁸

⁸ <http://mhc.org.mk/announcements/576#.WQxgrNJ97IU>





Meqenëse obligimet të cilat i ka policia nuk janë treguar në vepër, ministri i punëve të brendshme, Agim Nuhiu në konferencën për shtyp më 28 prill tha se duhet të mbajnë përgjegjësi dhe një pjesë e strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat nuk e kanë kryer punën e vet. Duke folur mbi pamundësinë e komunikimit me udhëheqësin e Shtabit Operativ në MPB, Mitko Çavkov dhe që të intervenohet në mënyrë përkatës, ministri Nuhiu theksoi se “për keqardhje, është evidente se në strukturat e MPB-së ndikimi politik ka rol të madh” dhe se prandaj “një pjesë e të punësuarve në MPB në vend që të respektojnë ligjet dhe t’i kryejnë obligimet e veta të punës, veprojnë sipas urdhrave të qendrave politike, diçka që duhet të dënohet fuqishëm dhe që duhet të sanksionohet me patjetër.”⁹ Sipas Nuhiut, MPB-ja nëpërmjet kontrollit të brendshëm, do të kërkojë përgjegjësi për të gjithë ata që nuk kanë vepruar në përputhje me autorizimet ligjore, duke përfshirë edhe anëtarët edhe udhëheqjen e Shtabit Operativ.

Sipas bilancit, janë lënduar 109 persona gjithsej midis të cilëve qytetarë, 22 nëpunës policorë dhe dhjetëra deputetë¹⁰, kryesuesi i partisë opozitare LSDM, Zoran Zaev, theksoi se “Dhuna mbi përfaqësuesit e rinj të zgjedhur me legjitimitet është nxitur nga Nikolla Gruevski, Gjorgje Ivanov, Trajko Veljanovski, Mitko Çavkov dhe një grup bashkëpunëtorësh të tyre (...). Ajo që ndodhi dje në mbrëmje nuk është rezultat e individëve të hidhëruar. Dhuna është rezultat i mbetjeve të regjimit në rënie që 10 vjet ushtron dhunë mbi Kushtetutën dhe demokracinë në këtë shtet. Prandaj dita e djeshme në Parlament ishte testim për Maqedoninë dhe për të gjithë qytetarët.”¹¹

Liria e shprehjes dhe pluralizmi në media

Në lidhje me ngjarjet e 27 prillit, sidomos duke u përqendruar edhe në sulmet e disa gazetarëve/gazetareve dhe ekipeve të gazetarëve, si ato mbi Biljana Sekullovsken nga “NOVA TV”, ekipin e gazetarëve të TV “Telma” dhe të Radios Evropa e Lirë, nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale u shpreh dënimi më i ashpër kundër dhunës mbi gazetarët/gazetaret dhe ekipet e gazetarëve. Siç theksuan nga kjo Agjenci: “Në momente të tilla të tensionuara, me rëndësi enorme është t’u mundësohet profesionalistëve të mediave ta kryejnë pa pengesë dhe të sigurt punën e vet. Ata janë aty që të informojnë publikun mbi evenimentet shoqërore-politike dhe nga kjo rrjedh se çdo dhunë mbi ta është e papranishme dhe është sulm i drejtpërdrejtë mbi lirinë e shprehjes.”¹² Agjencia u bëri thirrje radiodifuzerëve “t’u përmbahen rreptësisht parimeve profesionale për kryerjen e veprimtarisë” dhe u rikujtuan se duhet të informojnë në mënyrë objektive dhe të paanshme, duke siguruar të gjitha qëndrimet relevante të cilat do t’i trajtojnë në mënyrë të barabartë në të gjitha aspektet gjatë emisioneve aktuale-informative, qëllimi i të cilave është shqyrtimi analitik i çështjeve aktuale,

⁹ <http://www.mvr.gov.mk/vest/4048>

¹⁰ <http://a1on.mk/archives/733061>

¹¹ <http://www.sdsm.org.mk/News.aspx?idNews=8995&lng=1&cat=1>

¹² http://avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3234%3A2017-04-28-09-25-08&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk





gazetarët/gazetaret duhet të kenë kujdes, as ata/ato as bashkëbiseduesit të mos përdorin gjuhë diskriminuese i cili nxit urrejtje, ofendime, shpifje apo dezinformacione.¹³

Avokati i Popullit

Edhe zyra e Avokatit të Popullit, reagoi në lidhje me ngjarjet e 27 prillit, me dënim të fuqishëm të tyre, si dhe duke theksuar se policia nuk ka reaguar pothuajse fare dhe nuk e ka ndaluar turmën të hyjë në Kuvend, pas së cilës janë lënduar deputetë nga shumica parlamentare, si dhe ekipe të gazetarëve. Në lidhje me këtë, nga zyra e Avokatit të Popullit shpallë: “Në një shtet demokratik nuk ka vend për dhunë. Tani është e nevojshme t’u mundësohet formimi i institucioneve sepse legjitimiteti fitohet në zgjedhje dhe jo me dhunë. Avokati i Popullit bën thirrje për vetëdijesim sidomos liderëve të partive politike të cilët pikërisht tani duhet të dalin dhe të bëjnë thirrje për qetësim të emocioneve. Njëkohësisht, Avokati i Popullit u bën apel qytetarëve të mos bien pre e provokimeve.”¹⁴

Liria e Tubimit

Një grup qytetarësh, me moton “Të bashkuar për fëmijët dhe të rriturit me nevoja të nevojshme” të udhëhequr nga shoqëria “Splloteni sërca”, ngritën iniciativë me qëllim që të dëgjohet zëri i fëmijëve dhe të rriturve me nevoja të veçanta, si dhe që të sensibilizohet publiku për jetën e këtyre personave. Iniciativa në fokusin e vet i ka politikanët pa dallim të përkatësisë së tyre politike, me apel që të bashkohen në lidhje me çështjen e këtij problemi jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe të hidhur për personat me nevoja të veçanta dhe për familjet e tyre. Prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta organizuan një tubim paqësor më 20 prill, me paraqitje të rregullt në kohë të tubimit në polici (SP Qendër), i cili do të përfshinte dhe vendosjen e çadrave para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Përveç kësaj, me përpjekje për ndalim dhe pengim të tubimit publik (neni 155 i Kodit Penal), sipas mbikëqyrësve të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në RM, “gjatë tubimit personat e mbledhur janë vizituar nga persona përfaqësues të Qytetit të Shkupit, të cilët filluan t’i heqin banerët e vendosur në përmendoren përballë Kuvendit me arsyetimin se organizatorët nuk kanë marrë leje nga Qyteti i Shkupit për vendosjen e banerëve në përmendore. Meqenëse asnjë prej të pranishmëve nuk ka qenë i informuar se nevojitet një leje e tillë, përgjigja ishte se do ta nxjerrin menjëherë lejen e kërkuar sepse nuk duan asnjë lloj problemesh. Ndërkohë që të gjithë të pranishmit bisedonin me përfaqësuesit e Qytetit të Shkupit, pa prituri u shfaq një person i panjohur dhe filloi t’i heqë me dhunë çadrat e vendosura përballë Kuvendit në parkun “Zhena borec”. Personi është penguar nga të pranishmit dhe i është kërkuar që të legjitimohet dhe të japë shpjegim pse po i heq me dhunë çadrat. Personi as u dha

¹³ http://avmu.mk/index.php?option=com_content&view=article&id=3208%3A2017-04-10-13-50-09&catid=88%3Asoopstenija-media&Itemid=313&lang=mk

¹⁴ <http://sdk.mk/index.php/glasno-za-ombudsmanot/narodniot-pravobranitel-bara-politsijata-da-go-sprechi-nasilstvoto-vo-sobraniето/>





network23@epi.org.mk

Këtë rishikim e përgaditën anëtarët e Rrjetit 23+, i cili vepron në fushat e përfshira me Kapitullin 23 nga aderimi në BE, gjyqësori dhe të drejtat themelore.



përgjigje këtyre pyetjeve dhe as u legjitimua dhe vetëm deklaroi se çadrat duhet t'i largojnë vetë njerëzit ose ai vetë do t'i heqë, dhe pas një zënke të shkurtër u largua. Edhe pse në afërsi kishte persona zyrtarë të policisë, asnjë përfaqësues nuk erdhi kur iu bë thirrje prej të pranishmëve në tubim.”¹⁵

¹⁵ <http://mhc.org.mk/announcements/569#.WQxrFNJ97IU>



Projekti Rrjeti 23+ është i finansuar nga Bashkimi Europian. Qendrimet e shprehura në këtë dokument janë mendime të autorëve dhe jo çdo herë i reflektojnë mendimet e donatorit.